



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

*VENDIM*

*Nr. 124, Datë 16.08.2017*

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “RREGULLAVE TË PËRKOHËSHME PËR MEKANIZMIN BALANCUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16, 98 dhe 100 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 19 pika 1, gërma “f” dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Proçedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.08.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për Draft - Rregullat e përkohëshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- OST sh.a. me shkresën e saj nr. 4176 Prot., datë 01.08.2017 paraqiti në ERE për miratim draftin e Rregullave të përkohëshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike.
- Rregullorja është hartuar nga OST sh.a. në përputhje me nenet 98 dhe 100 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”
- OST sh.a. në shkresën e sipërcituar ka bërë me dije se drafti i këtyre Rregullave është përgatitur me mbështetjen e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në kuadër të mbështetjes teknike të ofruar për këtë qëllim.
- Në kuadër të kësaj asistence procesi i draftimit të këtyre rregullave ka përfshirë edhe organizimin e seminareve e takimeve të përbashkëta me palët e interesit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Rregullave të përkohëshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.